



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.01/256
Datë: 02.04.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet procesin e nisur nga Mbretëria e Bashkuar dhe Republika e Francës, për trajtimin e përhapjes dhe përdorimit të papërgjegjshëm të aftësive komerciale të ndërhyrjes kibernetike ("Procesi Pall Mall").
2. Në kuadër të procesit sipas pikës 1. të këtij Vendimi, Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh mbështetjen për Kodin Praktik të Shteteve, që do miratohet në konferencën e dytë të procesit Pall Mall në Paris me datat 3 dhe 4 prill 2025.
3. Kodi Praktik i Shteteve nga pika 2. e këtij Vendimi, i bashkëngjitet Vendimit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.02/256
Datë: 02.04.2025

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 75,000€ (shtatëdhjetepesë mijë euro) për Fondacionin Shqiptaro-Amerikan, me qëllim të promovimit të vendit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi "Programi për Promovim të Vendit" dhe barten në xhirollogarinë e organizatës respektive.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë